



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1798 / Prot.

Patos, më 16/07 / 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 15 KORRIK 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:30

Dëgjesë publike me temë: "Plani Social 2025-2028"

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe kërkesës me nr. 1669/1 prot., datë 02.06.2025 të Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit për zhvillimin e dëgjesës publike.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli , Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Përfqësues nga Drejtoria e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, rreth 32 pjesëmarrës (kryetarë të fshatrave, përfaqësues të banorëve të qytetit të Patosit, përfaqësues të institucioneve publike dhe jopublike, OJF etj).

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetar i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

"Plani Social 2025-2028"

Korrik 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1669/1 prot., datë 02.06.2025 të Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit për zhvillimin e dëgjesës publike lidhur me Planin Social 2025-2028, sot jemi mbledhur për të marr komentet dhe rekomandimet lidhur me draft planin Social 2025-2028 të hartuar për bashkinë Patos. Ju ftoj të gjithëve të ndiqni prezantimin e përfaqësuesve të bashkisë dhe jemi të hapur për të marr komentet dhe rekomandimet tuaja.

Zv/ Kryetare e bashkisë, znj. Ina Sauli– përshëndetje të gjithëve! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë e kësaj dëgjese publike dhe keni gjetur kohën për të sjell rekomandimet tuja lidhur me Planin Social.



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos
Znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Social 2025-2028”

Korrik 2025

Drejtoreshë e Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj



**Drejtoreshë
znj. Elda Goxhaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Social 2025-2028”

Korrik 2025

përshëndetje të gjithëve! Në këtë plan pak a shumë kemi ruajtur të njëjtën logjik me planin e parë dhe në objektiva pasi ato janë në nivel makro dhe duhet të mbulojnë të gjitha kategoritë. Ju mund të propozoni komente dhe sugjerimet tuaja pasi është shumë e rëndësishme që ky plan të ndahet dhe me mendimin qytetarë dhe me mendimin e ekspertëve. Do ju prezantojmë

objektivat dhe qëllimet. Do ndalemi pak të ofrimi i shërbimeve, përfituesit, kush do jenë shërbimet që do ofrohen dhe kush do t'i ofrojë këto shërbime etj. Për sa i përket analizës së situatës në bashkinë Patos funksionon vetëm një Qendër e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, e financimit të përzier, në të cilën përfitojnë shërbim 22 fëmijë me AK. Përfituesit e ndihmës ekonomike janë të ndarë në tregues në plan dhe të gjithë kanë nevojë të paktën për një shërbim. Struktura në Bashki është një drejtor dhe tre punonjës kurse struktura në Qendrën Multifunkionale është 4+1.

Njësia e Vlerësimit të Nevojave për Referim rasti nuk është krijuar dhe jemi në biseda për ta ngritur në të ardhmen. Problematikat që duam të përmendim janë: Mungesë shërbimesh, pamjaftueshmëri stafi, pamundësi integrimi/gjithëpërfshirje. Për sa i përket grupeve të ndara sipas prioriteteve kemi bërë një analizë që është sasiore dhe cilësore. Në analizën cilësore ne prioritet u kemi dhënë fëmijëve nisur edhe nga situata e krijuara në kohët e fundit. Fëmijët në situata risku janë të parët. Qëllimi strategjik i planit:

Deri në vitin 2028, çdo person dhe familje në territorin e bashkisë Patos, kryesisht ata persona dhe familje të konsideruara në nevojë për shkak të përjashtimit shoqëror ose rrezikut të përjashtimit, do t'ju sigurohet mundësia e barabartë për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror të cilësishme dhe në përputhje me nevojën e tyre. Kjo do të mundësohet përmes një sistemi funksional dhe të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në një mjedis të shëndetshëm, nxitës dhe mbështetës të institucioneve dhe komuniteteve, të gatshme për të realizuar përgjegjësitë e tyre për realizimin e të drejtave sociale.

Për sa i përket objektivave të Planit Social i kemi renditur në tretë tilla:

Objektiv 1 : Përmirësim, zgjerim shërbimesh dhe forcimi i sistemit ekzistues të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki i aftë të sigurojë shërbime të mbrojtjes, përkujdesit, integritetit dhe përfshirjes për të gjitha grupet në nevojë, të identifikuar dhe vlerësuar si të tilla, në përputhje me standartet kombëtare të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Objektiv 2: Krijimi i një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetësore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë.

Objektiv 3: Fuqizim të kapaciteteve institucionale, njerëzore, financiare, teknike të Bashkisë

Përveç këtyre objektivave kryesor kemi edhe ato specifik. Në dokumentin strategjik janë të shtjelluara akoma edhe më shumë. Objektivi specifik 1.1: Vijim i ofrimit të shërbimit për funksionimin e Qendrës Multifunksionale, duke shtuar shërbime të tjera si logopedia, fizioterapia etj.

Objektivi specifik 1.2: Sigurim shërbime sociale për “Individë mbi 18 vjeç me AK dhe Invalidët” nëpërmjet ofrimit të “Shërbimeve në familje” (për persona që e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal).

Objektivi specifik 1.3: Sigurim shërbime sociale për të moshuar nëpërmjet ofrimit të “Shërbimeve në familje” (për persona që e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal).

Objektivi specifik 1.4: Sigurim shërbime të nxitjes të punësimit dhe vetëpunësimit, formimit profesional, sipërmarrjes dhe fuqizimit ekonomik.

Objektivi specifik 2.1: Fuqizim të kapaciteteve të institucioneve të qeverisjes vendore në drejtim të rritjes së komunikimit dhe bashkëpunimit me public, komunitetet, grupet e përjashtuara dhe aktorë të tjerë për të krijuar dhe ofruar shërbimeve të qëndrueshme.

Objektivi specifik 2.2: Ndërgjegjësim të komuniteteve të qytetarëve për të drejtat e tyre si edhe mundësitë e realizimit.

Objektivi specifik 2.3: Ndërgjegjësim të aktorëve dhe operatorëve të biznesit, të shoqërisë civile si edhe të komunitetit ndërkombëtar, për bashkëpunim e partneritet për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të shërbimeve sociale.

Objektivi specifik 3.1: Fuqizim të kapaciteteve të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve si edhe të gjithë seksionit të shërbimeve sociale.

Objektiv specifik 3.2: Aftësim profesional të ofruesve të shërbimeve sociale.

Pasi në të marrim rekomandimet tuaja në këtë dëgjese publike do të plotësojmë edhe disa të dhëna të tjera buxhetore kidhur me planin dhe më pas do ta kalojmë në Këshillin Bashkiak. Ju faleminderit!

Kryetar i fshatit Siqecë, z. Myftar Sorraj- Përshëndetje! Unë e ndoqa me vëmendje prezantimin tuaj dhe dua të them që sot aktualisht në Siqecë janë tre kryefamiljar të paralizuar. Çfarë mund të marrin dhe përfitojnë ndonjë ndihmë nga shporta këta persona? A mund të marrin ata ndonjë pako ushqimore? Ndonjë aparat tensioni, ndonjë aparat diabeti?



**Kryetar i fshatit Siqec
z. Myftar Sorraj**

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Social 2025-2028”

Korrik 2025

Drejtores e Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj- lidhur me pakon ushqimore kjo është diçka e zgjidhshme dhe mund të bëhet, por është vetëm një zgjidhje momentale. Ajo që mund të bëjmë është që ju të referoni këto raste dhe në të marrim më shumë të dhëna për ta në mënyrë që t’ju informojmë lidhur me përlitimet që mund të kenë siç janë PAK, ndihma ekonomike etj.



**Drejtores
Znj. Elda Goxhaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Social 2025-2028”

Korrik 2025

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Eduart Faslliaj- përshëndetje! Doja të pyesja si e keni



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Eduart Faslliaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Social 2025-2028”

Korrik 2025

marrë informacionin dhe si e merrni lidhur me problematikat e bashkisë Patos? Më specifike si merrni informacion nga fshatrat apo nga lagjet e qytetit dhe kush është metodologjia e

marjes së informacionit? Bëhet fjalë për persona që nuk janë të zot për tu paraqitur pranë bashkisë për tu informuar lidhur me shërbimin. Në lagjen time kam shembuj konkretë të këtyre personave. Si mund të evidentohen këta raste? Persona pa banesë, të paaftë etj.

Drejtoresë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj- Ne funksionojmë me referim rasti. Nëse është fëmijë na e referojnë psikologët e shkollave, gratë na i referojnë nga policia, familjet na i kanë referuar kryetarët e fshatrave dhe kështu me radhë.



**Drejtoresë
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Plani Social 2025-2028”**

Korrik 2025

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Eduart Faslliaj- A keni ju një strukturë të dedikuar për terrenin që mbledh, evidenton dhe referon të gjitha këto raste dhe kontrollon në terren?



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Eduart Faslliaj**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Plani Social 2025-2028”**

Korrik 2025

Drejtoresë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj- Është e pamundur për kushtet që ne kemi që të kemi një strukturë të veçantë vetëm për këtë detyrë. Prandaj ne funksionojmë vetëm me referim rasti nga bashkëpunëtorët dhe kolegët tanë siç janë policia, psikologjia, kryetarët e fshatrave etj.



**Drejtore
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Social 2025-2028”**

Korrik 2025

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Eduart Faslliaj- Për rastin e qytetit e nuk kemi akoma një



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Eduart Faslliaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Social 2025-2028”**

Korrik 2025

strukturë që të referoj rastet. Unë do të vij me propozimin për krijimin e një strukture të tillë dhe qëllimi pse po bëj këtë kërkesë është sepse unë banoj në lagjen “Mustafa Matohiti” dhe aty ka disa problematika sociale që ndër vite s’i ka adresuar askush. Çfarë do të ndodh me këtë kategori? Në lagjen tonë kemi persona që nuk kanë patur mundësi të merrnin informacion. Rast konkret është një i sëmurë i cili endej rrugëve dhe unë kam telefonuar policinë për dy orë rresht. Ne në atë lagje kemi shumë probleme dhe njerëz që kanë nevojë të trajtohen, por nuk kanë patur mundësi të referohen. Pra unë vij me rekomandimin që të ketë një strukturë të tillë komunitare që të adresojë problematikat e lagjeve dhe ti evidentoj në terren.

Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Fier, z. Albert Sema- Përshëndetje!

Ato që u diskutuan janë me vend sepse të gjithë duhet të kenë informacion se ku duhet te drejtohen, por unë dua të them që i gjithë sistemi i referimit është i kopsitur që do të thotë se administratori i njësive administrative, punonjësi social, psikologu, shërbimi social shtetëror gjatë punës kontrolluese në terren etj në të gjitha rastet ne evidentojmë, referojmë raste problematike dhe i shtrojmë për zgjidhje dhe këtu përfshihen të gjithë institucionet që janë

një grup teknik për menaxhimin e rasteve të fëmijëve, grup për dhunën ku futen kryetarët e fshatrave etj dhe kanë për detyrë të referojnë rastet bashkë me personelin tjetër. Kjo është e njëjta edhe për lagjet e qytetit. Këto plane bëhen me qëllim që fondet të investohen për ato çfarë vërtet kanë nevojë më shumë njerëzit dhe sidomos grupet vulnerabël. Ne po luftojmë fortë që të ndërtojmë qendrën komunitare që ofrojnë shërbime për qytetarë që përfshijnë disa grupe të ndryshme si të rinjtë, të moshuarit, gratë etj. Ne kemi projekte komunitare që fëmijët që nuk kanë familje vijnë pasdite dhe e marrin shërbimin nga qendrat komunitare. Kemi edhe një problem shumë të madh me prindërimin. Kemi një problematik në menaxhimin e rasteve të personave me probleme të shëndetit mendor. Tashmë nuk lejohet të ngresh qendra për ti mbyllur këta persona. Ne jemi munduar t'i menaxhojmë këto raste. Jemi në rrugë për t'i zbatuar të gjitha këto. Kemi një qendër multifunksionale për PAK, e cila po funksionon shumë mirë dhe prindërit janë të kënaqur më shërbimin.



**Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të
Shërbimit Social Fier
z. Albert Sema**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Plani Social 2025-2028”**

Korrik 2025

Drejtor i shoqatës ambientaliste Zharrëza, z. Qani Rredhi- A ka politika për personat që janë të varur nga lëndët narkotike të përfshira në planin tuaj?



**Drejtor i shoqatës ambientaliste
Zharrëza
z. Qani Rredhi**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Plani Social 2025-2028”**

Korrik 2025

Drejtore e Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj-
Kemi përfshir në objektivat e planit vetëm fushata sensibilizuese dhe ndërgjegjëse, por jo integruese, sepse nuk kemi qendra integruese për këta persona.



**Drejtore
Znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Social 2025-2028”**

Korrik 2025

Përfaqësues i Prefekturës, z. Agim Gjondedaj- unë jam banues në Fier dhe unë shikoj që rrugët janë të mbushur plot me persona me probleme të shëndetit mendor dhe kjo është një situatë e cila duhet të menaxhohet. A keni menduar ndonjëherë që ju të krijoni ndonjë skuadër sidomos në zonat rurale për të referuar rastin konkret? A e keni ju mundësinë financiare që të keni një skuadër, një mjet që të gjendet aty në çdo moment? Gjithashtu a ka një regjistër ose një database lidhur me këto raste? A ka ndonjë shtëpi ditore për të moshuarit këtu në vendin tuaj?



**Përfaqësues i Prefekturës
z. Agim Gjondedaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Social 2025-2028”**

Korrik 2025

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Për sa i përket persoanave që kanë probleme të shëndetit mendor që enden ne kërkojmë mbështetjen tuaj që kjo të përforcohet kjo gjë dhe të gjendet një zgjidhje për këta persona në bashkëpunim me ju që zëri të bëhet edhe më i fuqishëm.



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Social 2025-2028”

Korrik 2025

Drejtore e Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj- ne kemi ngritur regjistrin elektronik regjistrohen rastet, ndërsa për shtëpi për të moshuarit ne kemi vetëm qendrën ditore Klubi i Pensionistëve, e cila shërben për të kaluar kohën e lirë të moshuarit gjatë ditës. Kemi patur edhe projekt për shërbimin në familje ku janë ofruar disa shërbime. Jemi duke u përpjekur që të zgjerojmë shërbimet e qendrave ekzistuese dhe të prioritzojmë shërbimet.



**Drejtore
znj. Elda Goxhaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Social 2025-2028”

Korrik 2025

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Nëse ju nuk keni komente, pyetje apo rekomandime të tjera unë e dakloroj të mbyllur këtë dëgjesë publike. Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj dhe shihemi në dëgjesa të tjera.

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba